



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.170

10 nëntor

2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.1409, datë 22.10.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Surroj të qarkut të Kukësit	8353
Vendim i KM nr.1410, datë 22.10.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Velabisht të qarkut të Beratit	8354
Vendim i KM nr.1411, datë 22.10.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Bradashesh të qarkut të Elbasanit	8355
Vendim i KM nr.1412, datë 22.10.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Vithkuq të qarkut të Korçës	8356
Vendim i KM nr.1415, datë 22.10.2008	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurat e prokurimit, të kryera nga Ministria e Shëndetësisë dhe Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, si autoritete kontraktore..	8357
Vendim i KM nr.1417, datë 10.10.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Vaqarr të qarkut të Tiranës	8359
Vendim i KM nr.1418, datë 10.10.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Përmet të qarkut të Gjirokastrës	8360

Vendim i KM nr.1419, datë 10.10.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Gjinar të qarkut të Elbasanit	8361
Vendim i KM nr.1423, datë 10.10.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Vau i Dejës të qarkut të Shkodrës	8362
Vendim i KM nr.1424, datë 10.10.2008	Për disa shtesa në vendimin nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të ministrave të linjës”, të ndryshuar	8363
Vendim i KM nr.1425, datë 22.10.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.824, datë 6.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e institucioneve të autorizuar për verifikimin, në mënyrë elektronike, të gjendjes gjyqësore, si dhe të formularit të vetëdeklarimit”, të ndryshuar	8365
Vendim i KM nr.1427, datë 22.10.2008	Për lejimin e kalimit transit të disa autokolonave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	8365
Udhëzim i MF&MPPTT nr.34, datë 27.10.2008	Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për pajisjen me lejedrejtim.....	8366
Vendim i GJK nr.23, datë 4.11.2008	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.255, datë 10.2.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; nr.122, datë 25.5.2005 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe nr.317, datë 15.3.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese	8367
Vendim i ERE nr.123, datë 24.10.2008	Për miratimin e kodit të funksionimit të rrjetit (kodit të transmetimit të energjisë elektrike)	8373
Vendim i ERE nr.124, datë 31.10.2008	Për fillimin e procedurave për ndryshime dhe shtesa në kontratën e furnizimit me energji elektrike për klientin e kategorisë familjare	8373
Vendim i ERE nr.125, datë 31.10.2008	Për fillimin e procedurave për ndryshime dhe shtesa në kontratën e furnizimit me energji elektrike për klientin e kategorisë jofamiljare	8374
	Ndreqje gabimi.....	8375

VENDIM
Nr.1409, datë 22.10.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS SURROJ TË QARKUT TË KUKËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Surroj, të qarkut të Kukësit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Surroj të qarkut të Kukësit, miratuar me vendimin nr.904, datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Surroj, të qarkut të Kukësit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Surroj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Surroj

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-6	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
9	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative.	Në pronësi
7	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
8	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
11-13	Varreza publike	Në pronësi
216-246	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
34,35,37,38,40,41,43	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
36,39,42	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka inproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
14-26	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi

VENDIM
Nr.1410, datë 22.10.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS VELABISHT TË QARKUT TË BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Velabisht të qarkut të Beratit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Velabisht të qarkut të Beratit, miratuar me vendimin nr.461, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Velabisht, të qarkut të Beratit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Velabisht për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Velabisht

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës	Në pronësi
186-201	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
53-67	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë	Në pronësi
96-108	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
202-238	Varreza publike	Në pronësi
68-91,93	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
95	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shërbimit social	Në pronësi
426-2355	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
2729-2741	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
92,109-185	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
2-5,7-10,12-15,17-19,21-31,33-36,38-52	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim

6,11,16,20,32,37	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi
------------------	---	------------

VENDIM
Nr. 1411, datë 22.10.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS BRADASHESH TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Bradashesh të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Bradashesh të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr.902, datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Bradashesh, të qarkut të Elbasanit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Bradashesh për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Bradashesh

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-16	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
17-22	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
24-172,174-214,216-291,508-517	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
518-555	Varreza publike	Në pronësi
173,215,846-892,894,895,906-910,915-1003,1007-1014,1018,1020-1022,1029-1058,1081-1083,1092-1108,1111-1183	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
556-558,560-562,564,565,567-572,575-577,579,582,585,586,588,589,591-594,597-599,601,602,604,606	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim

559,563,566,573,574,578, 580,581,583,584,587,590 595,596,600,603,605	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka inprodutive dhe kanale të treta)	Në pronësi
785-790	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr.1412, datë 22.10.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS VITHKUQ TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Vithkuq të qarkut të Korçës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Vithkuq të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.700, datë 19.10.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Vithkuq, të qarkut të Korçës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Vithkuq për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Vithkuq

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-11	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
12-16	Prona që përdoren në fushën e	Në pronësi

	shëndetit publik	
17-37	Prona që përdoren në fushën kulturore, sportive dhe buste historike	Në pronësi
38-63	Shërbim funeral	Në pronësi
64-66,87-91,103-111,119-133,150-154,180,181,186-195	Sheshe, lulishte, parqe, sipërfaqe të gjelbëruara	Në pronësi
67-86,92-102,112-118,134-149,155-179,182-185,759-765	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çfarëdo lloji	Në përdorim
201,202,205,208,211,212,214,215,218,219,221,222,223,225,226,227,229,230,231,233,234,236,237,238,240,241,243,244	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
675-689	Infrastrukturë rrugore	Në pronësi
203,204,206,207,209,210,213,216,217,220,223,224,228,232,235,239,242,245	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka inproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
690-725	Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm	Në pronësi

VENDIM

Nr.1415, datë 22.10.2008

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”, TIRANË, SI AUTORITETE KONTRAKTORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, të përfundojnë procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe ndërtime me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit, për vitin 2008, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, brenda datës 8 dhjetor 2008. Brenda këtij afati të përfshihet lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1

PROCEDURAT QË ZHVILLOHEN NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË

1. Blerje aparaturash laboratorike për disa D.H.E në rrethe dhe pajisje frigoriferike për shërbimin e morgut në disa spitale, me fond limit 22 500 000 (njëzet e dy milionë e pesëqind mijë)

lekë, pa TVSH.

2. Projektpreventiv zbatimi për ndërtimin e godinës të sëmundjeve akute-spitali Shkodër, me fond limit 1 333 334 lekë, pa TVSH.

3. Zgjerimi i infrastrukturës së komunikimit të rrjetit të Ministrisë së Shëndetësisë, me fondin limit 99 500 000 lekë, pa TVSH.

4. Instalimi, personalizimi i *soft-ware* dhe trajnimi i personelit të spitaleve rajonale dhe terciare, me fond limit 25 000 000 lekë, pa TVSH.

5. Shtrirja e shërbimit të hemodializës në sektorin spitalor privat.

Ministria po punon për nxjerrjen e një fondi prej 40 000 000 lekësh, i cili do të shërbejë për kryerjen e shërbimit të hemodializës në klinika private të specializuara.

6. Blerje aparaturash grafi-skopi, me fond limit 83 333 300 lekë, pa TVSH.

7. Furnizimi i institucioneve shëndetësore me materiale konsumi për laboratorë, me një fond limit 82 299 000 lekë, pa TVSH.

Procedura prokurimi që do të zhvillohen nga QSUT “Nënë Tereza” Tiranë

1. “Citostatike”, me fond limit 47 214 000 lekë;

2. “Kontraste” (1 lot kontrast jodik jonik për skaner dhe angiografi), me fond limit 14 000 000 lekë;

3. “Materiale mjekësore për kirurgjinë vaskulare”, me fond limit 5 306 780 lekë;

4. “Medikamente për kirurgjinë vaskulare”, me fond limit 5 632 000 lekë;

5. “Kite dhe reagentë”, me fond limit 60 000 000 lekë;

6. “Materiale për kardiokirurgjinë”, me fondin limit 6 289 000 lekë;

7. “Materiale mjekësore për neurokirurgjinë”, me fond limit 29 999 969 lekë;

8. Sigurimi, normalizimi dhe kontrolli i lëvizjes së pagesave të automjeteve të personelit që hyjnë në Qendrën Spitalore “Nënë Tereza”, me fond limit 2 083 333 lekë, pa TVSH;

9. Blerje aparaturash elektromjekësore për shërbimin e neurokirurgjisë QSUT “Nënë Tereza”, me fondin limit 21 666 667 lekë;

10. Blerje pajisjesh hotelerie për spitalin e rikonstruktuar pediatrik, me fond limit 5 600 000 lekë.

VENDIM

Nr.1417, datë 10.10.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS VAQARR TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen,

në pronësi ose në përdorim, të komunës Vaqarr të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Vaqarr të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.139, datë 8.3.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Vaqarr, të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Vaqarr për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Komuna Vaqarr

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-9	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
10	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore	Në pronësi
11-15	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
16-33	Shërbim funeral	Në pronësi
185-301,549, 553,558,562,566, 570,575,584	Prona që përdoren në fushën e infrastrukturës (troje)	Në përdorim
34-98,100-184	Infrastrukturë (rrugë vendore lulishte, trotuar)	Në pronësi
550,554,559,563,567, 571,576,581,585	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproductive, kanale të treta) dhe objekte të bujqësisë	Në pronësi
547,548,549,551,552,555,556, 557,560,561,564,565,568,569, 572,573,574,577,578,579,582,583	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim

VENDIM

Nr.1418, datë 10.10.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË PËRMET TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Përmet të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Përmet të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.140, datë 8.3.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Përmet, të qarkut të Gjirokastrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Përmet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Bashkia Përmet

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
132-136,139,140,145,146,148,152,154,155,158-162,165,166,168-170	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës	Në pronësi
1,3-16	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
17-34	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
38-41	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë	Në pronësi
43	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shërbimit social	Në pronësi
54,55	Varreza publike	Në pronësi
56-79,195-218	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
176-182	Prona që përdoren në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
45-53	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi

VENDIM

Nr.1419, datë 10.10.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS GJINAR TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Gjinar të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Gjinar të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr.537, datë 1.8.2003 të Këshillit të

Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të komunës Gjinar”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Gjinar për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Gjinar

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
30-39	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
3-5	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
40-44	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
25,26	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
18-24	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
7-17	Varreza publike	Në pronësi
58-66,68-74	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
469	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka inproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
54,55	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
Zona kadastrale nr.1742, pasuritë nr.150/73,151/109, 150/57,151/102,151/106,150/72, 150/66,151/103,150/76, 150/74, 150/75	Truall	Nuk transferohen

VENDIM
Nr.1423, datë 10.10.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË VAU I DEJËS TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Vau i Dejës të qarkut të Shkodrës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 128 (njëqind e njëzet e tetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 924 (nëntëqind e njëzet e katër).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Vaut të Dejës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Vau i Dejës

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-13	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
14-20	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
31-311,319	Infrastrukturë (troje të lira)	Në përdorim
24-30	Shërbim funeral	Në pronësi
21-23	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore	Në pronësi
325-330,335,338-340,342	Zhvillim ekonomik	Në pronësi
312-318,566-828,831-833,836-838	Infrastrukturë (rrugë vendore lulishte, trotuarë)	Në pronësi
553,903,909,911,918,923,924,896,	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive, kanale të treta)	Në pronësi
541-551,552	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim

VENDIM
Nr.1424, datë 10.10.2008

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.478, DATË 18.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

a) Në fund të shkronjës “b” të pikës 1 shtohet emërtesa “Qendra e shërbimeve dhe administrimit të mjeteve të transportit, të sistemit të Ministrisë së Brendshme.”.

b) Lidhja nr.1/5, e përmendur në pikën 2/5, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Në pikën 14/1 pas emërimit “... Shërbimit Informativ Ushtarak” shtohen “... dhe qendrës së shërbimeve dhe administrimit të mjeteve të transportit, të sistemit të Ministrisë së Brendshme..”.

2. Punonjësit mbështetës ekzistues të qendrës së shërbimeve dhe administrimit të mjeteve të transportit, të sistemit të Ministrisë së Brendshme, të cilët, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kanë përfituar një pagë më të lartë se ajo e parashikuar sipas vendimit nr.1231, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave, do të ruajnë nivelin e mëparshëm të pagës, deri në çastin e rishikimit të vendimit nr.1231, datë 2.7.2008, sipas përcaktimeve të tij.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2008, të përballohen nga fondet e miratuara për sistemin e Ministrisë së Brendshme dhe sistemin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare:

- për ndryshimin e parashikuar për Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, nga çasti i emërimit të nëpunësit;

- për qendrën e shërbimeve dhe administrimit të mjeteve të transportit, të sistemit të Ministrisë së Brendshme, nga data 1 gusht 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1/5

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË POZICIONET “SPECIALIST”
DERI NË “TITULLAR I INSTITUCIONIT” NË INSTITUTIN E SIGURISË USHQIMORE DHE
VETERINARISË

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			PAGA MUJORE
		1	2	3	SHTESA E POZICIONIT
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit	II-a	11.000	2%		103.500
Zëvendëstitullar i institucionit	II-b	11.000	2%		86.500
Përgjegjës departamenti	III-a	11.000	2%		68.500
Përgjegjës sektori, në sektorët e përmbajtjes Drejtor në drejtoritë mbështetëse	III-a/1	11.000	2%		58.300

Përgjegjës sektori, në sektorët mbështetës Specialist me grada e tituj shkencorë, në departamentet dhe sektorët e përmbajtjes	III-b	11.000	2%		51.500
Specialist pa grada e tituj shkencorë në departamentet dhe sektorët e përmbajtjes	IV-a	11.000	2%		39.000
Specialist zbatues pa grada e tituj shkencorë në departamentet dhe sektorët e përmbajtjes Specialist në sektorët mbështetës	IV-b	11.000	2%		29.000

VENDIM
Nr.1425, datë 22.10.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.824, DATË 6.12.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E INSTITUCIONEVE TË AUTORIZUARA PËR VERIFIKIMIN, NË MËNYRË ELEKTRONIKE, TË GJENDJES GJYQËSORE, SI DHE TË FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 7, 8 e 11 të ligjit nr.9614, datë 21.9.2006 “Për certifikatat elektronike të gjendjes civile”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në aneksin 1, që i bashkëlidhet vendimit nr.824, datë 6.12.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, te pjesa “Shënime”, fjalët “... ligjin nr.8517, datë 22.7.1999...” zëvendësohen me fjalët “... ligjin nr.9887, datë 10.3.2008...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1427, datë 22.10.2008

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË DISA AUTOKOLONAVE USHTARAKE

ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-porti i Durrësit, në datën 2 nëntor 2008, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 5 (pesë) automjete dhe 16 (gjashtëmbëdhjetë) trupa.

2. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-porti i Durrësit, në datën 3 nëntor 2008, të pesë autokolonave ushtarake italiane, të përbëra nga:

- Autokolona e parë, 20 (njëzet) automjete e 41 (dyzet e një) trupa;
- Autokolona e dytë, 20 (njëzet) automjete e 47 (dyzet e shtatë) trupa;
- Autokolona e tretë, 19 (nëntëmbëdhjetë) automjete e 23 (njëzet e tre) trupa;
- Autokolona e katërt, 20 (njëzet) automjete e 32 (tridhjetë e dy) trupa;
- Autokolona e pestë, 20 (njëzet) automjete e 41 (dyzet e një) trupa.

3. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin porti i Durrësit - Qafë-Thanë, në datën 5 nëntor 2008, të tri autokolonave ushtarake italiane, të përbëra nga:

- Autokolona e parë, 20 (njëzet) automjete e 41 (dyzet e një) trupa;
- Autokolona e dytë, 20 (njëzet) automjete e 35 (tridhjetë e pesë) trupa;
- Autokolona e tretë, 14 (katërmëdhjetë) automjete e 32 (tridhjetë e dy) trupa.

4. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonat, që do të kalojnë në datat 2 e 3 nëntor 2008, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonat, që do të kalojnë në datën 5 nëntor 2008, është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

5. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

6. Autokolonat ushtarake italiane, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

7. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.34, datë 27.10.2008

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR PAJISJEN ME LEJEDREJTIMI

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, Ministri i Financave dhe Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe

UDHËZOJNË:

1. Tarifa e pajisjes me lejedrejtimi për drejtimin e automjeteve është si më poshtë:
 - a) për lejedrejtimi të kategorisë A 3 000 (tre mijë) lekë;
 - b) për lejedrejtimi të kategorisë B 4 500 (katërmijë e pesëqind) lekë;
 - c) për lejedrejtimi të kategorisë C 2 000 (dy mijë) lekë;
 - ç) për lejedrejtimi të kategorisë D 3 000 (tre mijë) lekë;
 - d) për lejedrejtimi të kategorive BE, CE dhe DE 3 000 (tre mijë) lekë.
2. Për vjeljen e tarifës për pajisjen me lejedrejtimi për drejtim automjeti ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.
3. Detyrimi i pagimit të kësaj tarife lind në momentin e dhënies së dëshmisë së aftësisë për drejtim automjeti.
4. Shtetasi duhet të pajiset me dokumentin që vërteton pagimin e kësaj tarife. Të gjitha pagesat e tarifës do të regjistrohen në një regjistër të veçantë sipas shtojcës nr.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi dhe që është pjesë përbërëse e tij.
5. Për shërbimin e kryer, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor përfiton 5% komision të llogaritur mbi masën e tarifave që ka arkëtuar dhe ka transferuar në Buxhetin e Shtetit.
6. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE
TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

Shtojca nr.1

REGJISTRI DITOR I TARIFËS SË PAJISJES ME LEJEDREJTIMI
PËR DREJTIM AUTOMJETI

Nr.	Emër, mbiemër	Lloji i lejes së drejtimit	Masa e tarifës	Nr.i mandatarkëtimit

Drejtoria rajonale e transportit rrugor

VENDIM
Nr.23, datë 4.11.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datën 6.5.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.5 Akti që i përket:

KËRKUES: Ëngjëll Hysenbegasi, Arion Hysenbegasi, Daniela Cetri, Lindita Lulja, Isuf Melçani, Hero Melçani, Faik Minarolli, Mjesër Minarolli, Shkëlqim Minarolli, Luljeta Mulosmani, Fatlinda Selenica, Hysnie Minarolli, Gerond Minarolli, Armand Minarolli, Mynever Minarolli, Teuta Spaho, Kozeta Tola, Elvira Poncari, Entela Abaxholi, Ihsan Toro, Eno Toro, Denis Toro, të përfaqësuar nga av. Arqile Nini, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Zhuli Bregasi, Hektor Bregasi, të përfaqësuar nga av. Albens Tabaku, me prokurë. Viliam Bregasi, në mungesë.

Bashkia Pogradec (për llogari të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë bashkisë Pogradec), në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.255, datë 10.2.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; nr.122, datë 25.5.2005 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe nr.317, datë 15.3.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 134/”g”, 131/”f” dhe 42/1/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 27, 28, 29 dhe 30 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes, Petrit Plloçi, përfaqësuesin e kërkuësve av. Arqile Nini, i cili kërko i pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjekteve të interesuara av. Albens Tabaku, i cili kërko i rrëzimin e kërkesës, dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kërkuësit Ëngjëll Hysenbegasi etj., dhe subjektet e interesuara Zhuli Bregasi etj., janë përkatësisht trashëgimtarë ligjorë të vëllezërve Starova. Të dy palët, me kërkesa të veçanta, i janë drejtuar Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) pranë bashkisë Pogradec, duke kërkuar: kërkuësit - të njihen bashkëpronarë mbi objektin ish-muze dhe një godinë dykatëshe pas tij; subjektet e interesuara - të njihen pronarë të vetëm mbi këto objekte. Vendimet e KKKP-së, që kanë njohur bashkëpronarë mbi këto objekte trashëgimtarët e dy vëllezërve Starova, janë kundërshtuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila me vendimin nr.255, datë 10.2.2005 ka pranuar kërkesëpadinë, i ka njohur paditësit (subjekte të interesuara) pronarë të vetëm mbi pronën objekt konflikti dhe ka rrëzuar kundërpadinë e kërkuësve Hysenbegasi.

Ky vendim është lënë përfundimisht në fuqi me vendimin nr.122, datë 25.5.2005 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe me vendimin nr.317, datë 15.3.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kërkuësit pretendojnë se vendimet e mësipërme janë rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor dhe kanë kërkuar shfuqizimin e tyre, duke parashtuar:

- Gjykata e Apelit ka qenë e njëanshme në gjykimin e kësaj çështjeje, në trupin gjykues ka marrë pjesë një gjyqtar që kishte dhënë dorëheqjen më parë nga gjykimi.

- Çështja në shkallë të parë dhe në Gjykatën e Lartë nuk është shqyrtuar nga një gjykatë e caktuar me ligj.

- Vendimet gjyqësore të dhëna nga gjykatat janë të paarsyetuara.
- Përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, Zhuli Bregasi dhe Hektor Bregasi, kërkuar përpara Gjykatës Kushtetuese rrëzimin e kërkesës duke parashtruar:
 - Pretendimet për njëanshmëri të gjykatave nuk qëndrojnë. Kërkuar pretendojnë se gjyqtarët e apelit janë miq të ngushtë të paditësit, por nuk i kanë provuar këto pretendime.
 - Pretendimi se çështja nuk është shqyrtuar nga një gjykatë e caktuar me ligj nuk është ngritur në asnjë shkallë të gjykimin. Në këtë kuptim kërkuar nuk kanë ezauruar mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të tyre.
 - Lidhur me pretendimin për mosarsyetimin e vendimeve gjyqësore, gjykatat i kanë kushtuar vëmendje të gjitha provave, duke i çmuar ato në harmoni me njëra-tjetrën për zgjidhjen e kësaj çështjeje.

II

Për verifikimin e pretendimeve të ngritura, Gjykata Kushtetuese u përqendrua në aspektet që lidhen me të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor, parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës.

1. Lidhur me pretendimin për shkeljen e parimit të paanshmërisë në gjykimin në gjykatën e apelit

Kërkuar kanë pretenduar se në gjykimin e kësaj çështjeje, është shkelur parimi i paanshmërisë së gjykatës, sanksionuar në nenin 42/2 të Kushtetutës. Konkretisht, sipas kërkuarve, në trupin gjykues të Gjykatës së Apelit Korçë ka marrë pjesë një gjyqtar që ka pasur njohje me palën paditëse.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se, në kuadrin e parimeve kushtetuese që qëndrojnë në themel të një procesi të rregullt gjyqësor, respektimi i parimit të paanshmërisë mundëson krijimin e besimit që gjykatat duhet të gëzojnë në një shoqëri demokratike. Paanshmëria kërkon që drejtësia jo vetëm të bëhet, por dhe të shihet që bëhet. Në demokraci, ligjshmëria e rolit të gjyqtarit varet jo vetëm nga qenia e tij, por dhe nga shfaqja e tij i paanshëm dhe i pavarur, duke qenë roli i tij në mënyrë esenciale pasiv dhe *super partes*.

Ekzistenca e paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar dy teste: testin objektiv, që shqyrton nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë, dhe testin subjektiv, që ka të bëjë me bindjen e brendshme të gjyqtarit për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Nga pikëpamja e testit subjektiv, gjykimi konsiderohet i paanshëm derisa njëra nga palët, në rrjedhën e procesit, të paraqesë prova për të vërtetuar të kundërtën (vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.7, datë 11.3.2008 dhe nr.11, datë 2.4.2008).

Nga këndvështrimi i testit subjektiv, kërkuar nuk kanë vënë në dyshim bindjen e brendshme të gjyqtarit përkatës për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Prandaj, mbetet të shqyrtohet pretendimi nga pikëpamja e testit objektiv.

Në çështjen në gjykim, konstatohet se gjyqtari A.K., anëtar i trupit gjykues të Gjykatës së Apelit Korçë, i ka drejtuar kryetarit të kësaj gjykate një kërkesë për heqje dorë nga gjykimi. Ky i fundit, me vendimin datë 27.4.2005, ka rrëzuar kërkesën, duke arsyetuar se shkaqet e ngritura nga gjyqtari nuk janë të bazuara në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile dhe shprehet se “Është për t’u theksuar se paditësi Zhuli Bregasi ka njohje me të gjithë gjyqtarët e apelit, si dhe me personelin e administratës. Kjo lidhje ka të bëjë dhe me natyrën e paditësit, me rrethin e madh shoqëror që ka, si dhe me angazhimet dhe punët që kryen.”

Në rrethanat e mësipërme, Gjykata Kushtetuese vlerëson se Gjykata e Apelit Korçë, në përbërje të së cilës ka qenë edhe gjyqtari A.K., nuk i ka ofruar palës së paditur (kërkuarve) garancitë e nevojshme që do t’u largonin dyshimin për njëanshmërinë e gjykatës. Përkundrazi, megjithëse një nga anëtarët e trupit gjykues ka kërkuar të heqë dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje, kryetari i gjykatës jo vetëm nuk e ka pranuar këtë kërkesë, por ka deklaruar në vendimin e tij edhe njohjet e palës paditëse me gjyqtarët të kësaj gjykate, veprim ky që vë seriozisht në dyshim paanësinë e kësaj gjykate. Justifikimi i rrëzimit të kësaj kërkesë, me arsyetimin se shkaqet e ngritura nga gjyqtari nuk janë të bazuara në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile, nuk harmonizohet me detyrimin që kanë gjykatat

për respektimin e parimeve kushtetuese, të procesit të rregullt e të paanësisë.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se gjykata e apelit ka cenuar parimin e paanshmërisë si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

2. Lidhur me pretendimin se çështja në shkallë të parë dhe në Gjykatën e Lartë nuk është gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj

Kërkuesi e mbështet këtë pretendim në dy argumente, të cilat do të analizohen nga gjykata në vijim, të ndara nga njëra-tjetra.

2.1 Kërkuesi pretendon se gjykimi i çështjes në shkallë të parë është bërë nga një gjyqtar i vetëm, në vend që të gjykohej nga një trup gjykues i përbërë nga tre gjyqtarë.

Gjykata Kushtetuese konstaton se këtë pretendim kërkuesit e kanë ngritur vetëm në parashtrimet e tyre në seancën gjyqësore të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, më datë 15.3.2007, por nuk e kanë ngritur as në ankimin përpara Gjykatës së Apelit dhe as në rekurs.

Me këtë rast, Gjykata Kushtetuese rithekson se, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, shterimi i mjeteve të ankimit në gjykatat e zakonshme është një kusht, i cili bën të mundur juridiksionin kushtetues për shkelje të të drejtave themelore për një proces të rregullt. Në këtë mënyrë, ky rregull përbën një aspekt të rëndësishëm të parimit, se procedura e zgjidhjes së ankesave individuale përpara Gjykatës Kushtetuese është plotësuese (subsidiare) e gjykimit në gjykatat e zakonshme lidhur me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese (parimi i subsidiaritetit). Shterimi nënkupton që kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.17, datë 18.7.2005). Rregulli i shterimit të mjeteve, i vendosur nga neni 131/f i Kushtetutës, e detyron kërkuesin që për zgjidhjen e çështjes së tij t'u drejtohet të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme, përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Shterimi i mjeteve juridike nënkupton gjithashtu jo vetëm adresimin instancave të gjykatave të zakonshme, por edhe konsumimin, si rregull, para tyre të çdo pretendimi ligjor që parashtrohet si shkak shfuqizimi në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim kjo gjykatë, përderisa nuk është ngritur në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

2.1 Kërkuesi pretendon se edhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, për mënyrën e hedhjes së shortit dhe mënyrën e formimit të trupit gjykues, nuk ka qenë një gjykatë e caktuar me ligj, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

Sipas kërkuesve, relatori i çështjes, i shpallur fillimisht në Gjykatën e Lartë është zëvendësuar me një relator tjetër. Po ashtu, në gjykimin e çështjes në datën 15.3.2007, në përbërjen e trupit gjykues ka marrë pjesë një gjyqtar i pashpallur në listën për gjykimin e kësaj çështjeje në këtë datë dhe, sipas tyre, pjesëmarrja e tij në këtë trup gjykues nuk ishte hedhur në short.

Gjykata Kushtetuese konstaton se kjo çështje është shpallur në Gjykatën e Lartë për t'u gjykuar më datë 8.2.2007, duke u shpallur dhe emri i relatorit. Me kërkesën nr.H-54, datë 20.12.2006, pala paditëse në gjykim (Hektor Bregasi) i është drejtuar gjyqtarit relator duke i kërkuar që të heqë dorë nga çështja dhe nga trupi gjykues, duke hedhur dyshime mbi paanshmërinë e tij. Neni 73 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se "Gjyqtari, i cili vlerëson me ndërgjegje se ka shkaqe të arsyeshme për të mos marrë pjesë në shqyrtimin e një çështjeje, i kërkon kryetarit të gjykatës zëvendësimin e tij. Kryetari i Gjykatës, kur e sheh me vend kërkesën, urdhëron zëvendësimin e tij me një gjyqtar tjetër të asaj gjykate."

Nga dosja gjyqësore rezulton se gjykimi i kësaj çështjeje është shtyrë dhe është shpallur për t'u shqyrtuar në një datë tjetër, me një tjetër gjyqtar relator. Kjo vërteton se relatori i parë ka hequr dorë nga pjesëmarrja në shqyrtimin e kësaj çështjeje dhe se kjo kërkesë është pranuar nga kryetari i gjykatës. Dispozitat procedurale përcaktojnë si një nga detyrimet e administratës gjyqësore, gjatë zhvillimit të gjykimit në Gjykatën e Lartë, shpalljen e listave të shqyrtimit të rekurseve, të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit (neni 482/3 i Kodit të Procedurës Civile), detyrim që rezulton i respektuar nga kjo gjykatë.

Nga vendimi i Gjykatës së Lartë konstatohet, gjithashtu, se relatori i caktuar fillimisht nuk ka marrë pjesë në gjykimin e kësaj çështjeje as si anëtar i trupit gjykues, për të mos krijuar te palët dyshime mbi anshmërinë e tij në këtë gjykim. Përsa i përket pjesëmarrjes në këtë kolegji të gjyqtarit tjetër, neni 13 i ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, përcakton se “Kolegjet e Gjykatës së Lartë gjykojnë me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë. Kur trupi gjykues nuk mund të formohet nga gjyqtarët e një kolegji, ai plotësohet me gjyqtarë të kolegjit tjetër. Këta gjyqtarë caktohen me short.”

Në këto rrethana Gjykata Kushtetuese konkludoi se kërkuesi nuk ka vërtetuar se neni 13 i sipërcituar është shkelur nga Gjykata e Lartë dhe se pjesëmarrja e gjyqtarit tjetër nuk është hedhur në short nga kjo gjykatë. Po ashtu, fakti që ky gjyqtar është anëtar i Kolegjit Penal nuk e bën këtë proces të parregullt në kuptimin kushtetues.

3. Lidhur me pretendimin se vendimet gjyqësore nuk janë të arsyetuara

Kërkuesit kanë pretenduar se vendimet që kundërshtohen nuk janë bazuar në provat dhe në vendimet e gjykatës së formës së prerë. Sipas tyre, Gjykata e Apelit Korçë dhe Gjykata e Lartë në vendimet e tyre nuk kanë arsyetuar shkaqet ligjore, si e humbën ata pronësinë dhe si e fituan paditësit (subjekte të interesuara).

Gjykata Kushtetuese vë në dukje se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 142 të saj, sanksionon detyrimin e gjykatave të të gjitha niveleve për të arsyetuar vendimet e tyre. Gjykatat duhet të parashtrajnë në mënyrë të përmblendhur rrethanat e faktit, provat mbi të cilat bazohet vendimi, mënyrën e vlerësimit të këtyre provave, pra të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet mbi të cilat mbështesin vendimet e tyre.

Gjykata Kushtetuese thekson se vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimin, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmblendhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.33, datë 8.12.2005). Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, duke iu referuar procesit të drejtë, të garantuar nga neni 6 i Konventës europiane të të drejtave të njeriut, ka theksuar se “Neni 6 i detyron gjykatat të arsyetojnë vendimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet sikur kërkohet një përgjigje e detajuar për çdo argument” (vendimi i GJEDNJ në çështjen Van de Hurk kundër Holandës, 19 prill 1994, § 61).

Me këtë rast Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet se ku janë bazuar gjykatat për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave që zgjidhin çështjen, por në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata Kushtetuese konstaton nëse në procesin gjyqësor gjykatat kanë cenuar parimet kushtetuese që garantojnë respektimin e të drejtave të palëve gjatë këtij procesi. Funksion i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar. Nga ana tjetër, vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të realizohet një kontroll publik i administrimit të drejtësisë (vendimi i GJEDNJ në çështjen Hirvisaari kundër Finlandës, 27 shtator 2001, § 30).

Lidhur me çështjen në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese konstaton se Gjykata e Apelit Korçë dhe Gjykata e Lartë i kanë dhënë mundësi kërkuesit të parashtrijë pretendimet e tij dhe të paraqesë provat në mbrojtje të këtyre pretendimeve, i kanë administruar dhe çmuar këto prova sipas bindjes së tyre të brendshme dhe në përfundim të procesit, me vendim të arsyetuar, janë shprehur mbi mënyrën e vlerësimit të këtyre provave dhe zgjidhjen e çështjes konkrete në themel. Në këtë kontekst, në lidhje me këtë pretendim, procesi ligjor nuk mund të konsiderohet si i parregullt.

Në përfundim, Gjykata Kushtetuese vlerëson se procesi i zhvilluar në gjykatën e apelit, në tërësinë e tij, ka qenë i parregullt nga pikëpamja kushtetuese, pasi kjo gjykatë ka cenuar standardin kushtetues të paanshmërisë së gjykatës si një nga elementet thelbësore për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131, shkronja “f” dhe

134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr.122, datë 25.5.2005 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe nr.317, datë 15.3.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Korçë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vladimir Kristo (kryetar), Fehmi Abdiu, Kujtim Puto, Petrit Plloçi, Sokol Berberi.

Anëtarë kundër: Gjergj Sauli, Xhezair Zaganjori, Sokol Sadushi, Vitore Tusha.

MENDIM PAKICE

Jemi kundër vendimit të shumicës lidhur me kërkesën e Engjëll Hysenbegasi për këtë arsye:

Shumica ka pranuar pretendimin e kërkuarit se Gjykata e Apelit Korçë nuk ka respektuar parimin e paanshmërisë së gjykatës duke e paragjykuar çështjen. Si argument për këtë, kërkuari ka sjellë faktin se subjekti i interesuar ka njohje të gjera në këtë qytet, mes të cilëve edhe me gjyqtarët që kanë marrë pjesë në gjykimin e kësaj çështjeje. Për këtë shkak, procesi ka qenë që në fillim i paragjykuar, duke mos respektuar kështu parimin e paanshmërisë së gjykatës.

Ashtu siç shprehet edhe shumica në vendimin e saj, paanshmëria ka të bëjë kryesisht me pozicionimin subjektiv dhe objektiv të gjyqtarit gjatë gjykimit të një çështjeje. Gjyqtari, sipas këtij parimi, duhet të qëndrojë mbi palët dhe të marrë vendimin pa u ndikuar prej tyre, por vetëm duke u mbështetur në provat, dijet dhe bindjen e brendshme të vetë gjyqtarit. Ky parim dikton edhe prezumimin e paanshmërisë së gjyqtarit derisa të provohet e kundërta. Në këtë këndvështrim, shumica ka pranuar se nga ana subjektive gjyqtari nuk ka dhënë asnjë shkak që të provojë anshmërinë e tij. I vetmi argument që e bën palën të dyshojë në paanshmërinë e tij është fakti i njohjes së gjerë që ka pasur paditësi, përfshi këtu edhe njohjen e tij me një nga anëtarët e trupit gjykues, i cili në përputhje me të gjitha rregullat procedurale ka paraqitur dorëheqjen para kryetarit të Gjykatës për këtë shkak. Kryetari nuk e ka pranuar dorëheqjen, duke arsyetuar se vetëm shkaku i njohjes me paditësin nuk mund të përbëjë shkak për dorëheqje.

Pakica pajtohet me argumentin e kryetarit të Gjykatës së Apelit Korçë, pasi vetë fakti i njohjes me palët nuk mund të barazohet domosdoshmërisht me anshmërinë në gjykim. Ky fakt duhet të shoqërohet patjetër edhe me veprimet dhe qëndrimet e gjyqtarit gjatë tërë gjykimit, për të arritur në konkluzionin nëse ai ka respektuar apo jo parimin e paanshmërisë. Kështu p.sh. mund të shihet nëse gjyqtari gjatë gjykimit ka bërë pyetje sugestionuese ose të tilla që të përmbajnë dyshime për njëanshmëri duke favorizuar njërin palë apo duke vënë në pozita të pafavorshme palën tjetër; nëse gjyqtari u ka dhënë palëve në proces mundësinë e njëjtë për të shprehur pretendimet dhe argumentet e veta; nëse ai ka marrë apo jo provat e paraqitura pa cenuar të drejtat e palëve në proces etj.

Neni 72 i Kodit të Procedurës Civile ka parashikuar rastet dhe kushtet kur gjyqtari duhet të heqë dorë nga gjykimi i çështjes. Shumica nuk ka arritur të provojë asnjë nga këto elemente që të mund të vërtetonin cenimin e paanshmërisë nga Gjykata e Apelit Korçë. Vetëm pranimin e faktit të njohjes së gjyqtarit me paditësin pa pasur provë tjetër shtesë është në vetvete paragjykim nga ana e shumicës për gjykimin objektiv të gjyqtarit gjatë procesit gjyqësor. Jo vetëm kaq, por duke iu referuar përmbajtjes së nenit 73 të Kodit të Procedurës Civile, parashikohet e drejta e kryetarit për të vlerësuar kërkesën për dorëheqje të gjyqtarit nga gjykimi i çështjes. Nëse do të pranojmë arsyetimin e shumicës,

atëherë kryetarit të gjykatës i lind detyrimi të pranojë çdo lloj kërkesë për dorëheqje të gjyqtarëve pa pasur mundësinë reale ta çmojë atë nëse vërtet është e bazuar apo jo për të mos lënë shkaqe për dyshim. Një praktikë e tillë, mendojmë se nuk do t'i shërbente funksionimit normal të punës së gjykatave.

Për sa më lart, pakica mendon se ky pretendim nuk duhej të ishte pranuar si i pabazuar.

Anëtarë: Sokol Sadushi, Vitore Tusha, Xhezair Zaganjori.

VENDIM

Nr.123, datë 24.10.2008

PËR MIRATIMIN E KODIT TË FUNKSIONIMIT TË RRJETIT (KODIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE)

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “i”, 9 dhe 55 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, pika 7, si dhe shtojca E, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.53, datë 23.5.2008 “Për fillimin e procedurave për disa ndryshime në kodin e funksionimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, kodin e sistemit të transmetimit, dhe kodin e matjes së energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.10.2008, pasi shqyrtoi dhe analizoi draftin e kodit të funksionimit të rrjetit (kodit të transmetimit të energjisë elektrike) të përgatitur nga ana e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e kodit të funksionimit të rrjetit (kodit të transmetimit të energjisë elektrike) (kodi bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Shfuqizimin e vendimit nr.58, datë 28.12.2004 “Për miratimin e kodit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike (kodi i funksionimit të rrjetit të transmetimit)”.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S

Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.124, datë 31.10.2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR NDRYSHIME DHE SHTESA NË KONTRATËN E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE PËR KLIENTIN E KATEGORISË FAMILJARE

Në mbështetje të neneve 9, dhe 44, pika 3, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 18, të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.10.2008, pasi shqyrtoi propozimin për ndryshime dhe shtesa në kontratën e furnizimit me energji elektrike për klientët e kategorisë familjare,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.40, datë 31.8.2005 kontrata e furnizimit me energji elektrike për kategorinë e konsumatorëve familjarë.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për shqyrtimin e procedurave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.125, datë 31.10.2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR NDRYSHIME DHE SHTESA NË KONTRATËN E
FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE PËR KLIENTIN E KATEGORISË
JOFAMILJARE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 44, pika 3, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 18, të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.10.2008, pasi shqyrtoi propozimin për ndryshime dhe shtesa në kontratën e furnizimit me energji elektrike për klientët e kategorisë jofamiljare,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 31.8.2005, kontrata e furnizimit me energji elektrike për kategorinë e konsumatorëve jofamiljarë.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për shqyrtimin e procedurave.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

Ndreqje gabimi

Në vendimin nr.1344, datë 10.10.2008 “Për miratimin e rregullave “Për etiketimin e produkteve ushqimore”” botuar në Fletoren Zyrtare nr.160, në pikën 3, bëhet korrigjimi:

Fjala “modifikimin” të bëhet “**notifikimin**”.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 7.11.2008
Doli nga shtypi më 10.11.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Tiranë, 2008

Çmimi 26 lekë